



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2406 Prot.

Tiranë, më 15 / 07 / 2026

V E N D I M

Nr. 19, datë 10.07.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
MEKANIKE, ME NËNFUSHA INXHINIERI MEKANIKE DHE NËNFUSHA INXHINIERI
E MATERIALEVE, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MEKANIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 383, datë 25.07.2024, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Hulumtimi dhe optimizimi i parametrave të prodhimit për përmirësimin e cilësisë së pjesëve të realizuara me Selective Laser Sintering;
2. Zhvillimi dhe përdorimi i materialeve polimere të avancuara për aplikime industriale në teknologjinë e printimit 3D;
3. Riciklimi i mbetjeve të lëkurës në industrinë e prodhimit të këpucëve në Shqipëri. Një qasje drejt ekonomisë qarkulluese dhe menaxhimit miqësor me mjedisin;
4. Vlerësimi i shkallës së ndotjes së ujrave nga fibrat sintetike gjatë procesit të larjes/mirëmbajtjes së tekstileve dhe mënyrat e parandalimit si emergjencë në aspektin ekologjik;
5. Rritja e disponueshmërisë dhe sigurisë të hidrocentraleve ekzistues me kulla ekuilibri në Shqipëri;
6. Modelimi dhe optimizimi i sigurisë rrugore në Shqipëri përmes parimeve të Vizionit Zero: Një qasje e integruar inxhinierike;

7. Zhvillimi i një modeli për vlerësimin e ndikimit të investimeve në menaxhimin e cilësisë në performancën e ndërmarrjeve prodhuese.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Mekanike, me nënfusha Inxhinieri Mekanike dhe nënfusha Inxhinieri e Materialeve, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

